

VENDIM
Nr. 114, datë 2.3.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 730, DATË 3.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND PËR VITIN 2021”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 27, e të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 730, datë 3.12.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Tëitulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitet 2021 dhe 2022”.

2. Në pikat 1 dhe 2, fjalët “... vitin 2021 ...” zëvendësohen me “... vitet 2021 dhe 2022 ...”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Numri i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e pranimit të drejtpërdrejtë në TND, është 16 (gjashtëmbëdhjetë).”.

4. Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Në rast se numri i pozicioneve vakante të TND-së, sipas pikës 3, të këtij vendimi, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurrimit të nisur në vitin 2021, Departamenti i Administratës Publike zhvillon një procedurë të re pranimi të drejtpërdrejtë në TND gjatë vitit 2022 për numrin e pozicioneve të mbetura vakante dhe brenda numrit të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama